

Komuna e Lipjanit sërish nën llupën e auditorëve për probleme të njëjta

## Auditori i gjen Lipjanit telashe të pariparueshme për 3 vjet radhazi

Mangësitë të evidencuara nga raportet e auditorit të pavarur për vitin 2008 dhe 2009, nga Komuna e Lipjanit janë përsëritur edhe në vitin 2010, ndërkohë që në këtë plan ka reaguar edhe shoqëria civil e kësaj komune

KOHA  
Ditore

ARIAN DURIQI

LIPJAN, 19 QERSHOR – Komuna e Lipjanit është vënë sërish nën llupën e Auditorit të pavarur për probleme të njëjta, sepse siç flet evidenca zyrtare, telashtet nuk kanë arritur të riparohen as pas 3 vjetësh qysh kur ato ishin gjetur. Në bazë të raporteve të auditorit të pavarur del se për 3 vjet radhazi Komuna e Lipjanit nuk mirëmban ndonjë regjistër të përgjithshëm të ndërtesave, makinerisë dhe pajisjeve. Për më tepër, regjistri i ndërtesave, makinerisë dhe pajisjeve nuk është harmonizuar as me regjistrat kontabël të Komunës.

Gjithashtu mungon edhe një listë e detajuar gjithëpërfshirëse e pronës. “Mungon lista e cila përfshin dokumentacionin e pronësive dhe pronës të tillë dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emrin e Komunës në Kadastër, apo në Gjykatë. Për më tepër, Komuna nuk ka kryer verifikim dhe vlerësim fizik të të gjitha asetëve deri më 31 dhjetor 2010”, thuhet në raportin e sivjetmë. Po ashtu, ka vërejtje edhe në faktin se Komuna nuk e ka implementuar një program të integruar kompjuterik, apo kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacionin për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë. Komuna nuk ka implementuar as sistem



githëpërfshirës dhe automatik të faturimit dhe nuk mirëmban libra të veçantë, apo listë të të gjithë debitorëve në lidhje me tatime të ndryshme. Në vend të saj vetëm mbledhjet në para të gatshme janë të regjistruara. “Megjithëse llogaritë e arkëtuara kërkohen të shpalosen në pasqyrat financiare, mungesa e sigurisë dhe plotësisë do të ndikojë në të hyrat që Komuna mund të fitojë dhe aftësinë që të përgatisë buxhet të besueshëm dhe të sigurt, të raportojë shkallën e saktë të mbledhjes dhe të monitorojë mbledhjen e të hyrave vetjake në baza kohore”, vijon raporti. Ndërkohë që mangësitë të evidencuara nga raportet e auditorit të pavarur për vitin 2008 dhe 2009, e që nga

Komuna e Lipjanit janë përsëritur edhe në vitin 2010, kanë nxitur reagime edhe nga shoqëria civile e kësaj komune. Organizata joqeveritare e të rinjve YAHR, ka reaguar dhe ka kërkuar nga autoritetet komunale që t'i riparojë telashtet që përsëriten për tri motmote radhazi. Bekim Krasniqi, udhëheqës i kësaj organizate ka ftuar ekzekutivin e Lipjanit që të jetë më serioz kur janë në pyetje mangësitë që hetohen nga auditorët. “Organizata joqeveritare YAHR, reagon ndaj ekzekutivit të Komunës së Lipjanit për mosseriozitet ndaj vërejtjeve dhe mangësi të evidencuara nga Raportet e auditorit të pavarur, mangësi këto që janë përsëritur vit pas viti 3 herë”, ka thënë ai.



Komuna vlerëson dëmin e shkaktuar nga reshjet e fundit të shiut dhe bresahrit

## Kaçaniku i kërkon 600 mijë euro nga Qeveria e Kosovës për dëmet e stuhisë

Zyrtarë komunalë kanë theksuar se Komuna nuk ka fond për intervenime në situata emergjente, ndërsa për shkak të buxhetit të limituar nuk ka mundësi të bëhet ridestitim mjetesh për këtë qëllim nga linjat e tjera buxhetore

EKREM RAKA

KAÇANIK, 19 QERSHOR – Komuna e Kaçanikut u ka bërë kërkesë me shkrim instancave përgjegjëse të Qeverisë së Kosovës për alokim mjetesh për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga stuhia e fundit me reshje të mëdha shiu të shoqëruara me breshër. “Ekipi i caktuar për konstatimin e dëmit të shkaktuar nga stuhia e 8 qershorit ka vlerësuar se ai është në lartësi prej 605.540 eurosh”, ka theksuar Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës të Kaçanikut, të dielën. Vlerësuesit kishin ardhur në përfundim se dëmi në bujqësi është 273.540 euro, ndërsa në infrastrukturë 339.628 euro. “Një kërkesë për mbështetje financiare për sanimin e gjendjes i është dërguar Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave dhe Bajram Rexhepit,

ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme”, ka nënvizuar Dullovi. Ai ka thënë se kërkesa për mbështetje financiare është firmosur nga Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës. Pohimet e zëdhënësit Dullovi i ka konfirmuar drejtori Ceka. “Një kërkesë tjetër për mbështetje financiare për sanimin e dëmeve në infrastrukturë do t'i adresohet edhe Ministrisë së Infrastrukturës”, ka theksuar Ceka. Ai ka nënvizuar se Komuna nuk ka fonde për intervenim në situata emergjente. “Komuna nuk ka fond për intervenime në këso situatash, ndërsa për shkak të buxhetit të limituar nuk ka mundësi të bëhet ridestitim mjetesh për këtë qëllim nga linjat e tjera buxhetore”, ka deklaruar ai.